

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6949
E premte, 21 korrik 2023
Çmimi 0.40 €

Konjufca në Francë:
Arritjet e shtetit tonë,
suksese edhe
të aleatëve tanë | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RRETH 57 PËR QIND E FAMILJEVE NË KOSOVË NUK KANË MUNDËSI TË BËJNË PUSHIME VERORE



Përfaqësues të bizneseve, të cilat bëjnë oferta për pushime jashtë Kosovës, thonë se çmimi i tyre është rritur për së paku 15 për qind më shumë se një vit më parë. Të dhënat e

fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës tregojnë se çmimet e larta të produkteve të konsumit të përditshëm dhe të shërbimeve të tjera, përballë nivelit të

pagave në vend, ua pamundësojnë rreth 57 për qind të familjeve në Kosovë përballimin e një pushimi njëjavor, qoftë në det apo diku tjetër



**PKD-JA E ÇON NË
KUSHTETUESE VENDIMIN
E KONJUFÇËS PËR
SEANCËN KU U VOTUA
EDHE LIGJI PËR PAGËN
MINIMALE** | FAQE 5

**PËRFUNDON
DËSHMINË
DËSHMITARI I 15-të,
GJYKIMI NDAJ
THAÇIT DHE TË
TJERËVE RINIS
MË 14 GUSHTI** | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE



**AMBASADORIT TË BE-SË I ZGJATET
MANDATI NË KOSOVË EDHE PËR
NJË VIT** | F. 5

**10 MIJË UDHËTARË MË SHUMË
PREJ BILETAVE DITORE
NË KRYEQYTET** | F. 6

**HARADINAJ: ËSHTË KOHA E FUNDIT
QË KURTI TË LARGOHET NGA TEMAT
TENSIONUESE DHE DESTRUKTIVE** | F. 7

EKONOMI



**KMDLNJ: ZRRE-ja DINTE T'I
PLAÇKISTE QYTETARËT, TASH NUK
DI SI T'I KOMPENSOJË!** | F. 8

**HOTI PËRMEND KATËR PROBLEME
TË PAGËS MINIMALE** | F. 8

SPORT



**KOSOVA SYNON KUALIFIKIMIN NË
EVROPIANIN U22 NË VOLEJBOLL** | F. 10

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjashtë të vdekur dhe qindra të lënduar nga stuhia që përfshiu Ballkanin

LUBJANË, 20 KORRIK - Një zjarrfikës kroat ka vdekur gjatë stuhisë vdekjeprurëse që përfshiu Ballkanin pas një vale të të nxehtit, duke e çuar numrin e të vdekurve në gjashtë, thanë zyrtarët më 20 korrik.

Në të gjithë Ballkanin autoritetet raportuan qindra të lënduar, duke përfshirë disa në gjendje më të rëndë, nga pemët, pjesët e çative ose objekte të tjera të rrëzuara nga erërat e forta.

Pas disa ditësh shumë të nxehta dhe të thata, Ballkani përjetoi stuhinë e dytë brenda dy ditësh, teksa pjesë të tjera të Evropës po luftojnë me zjarre dhe temperatura të larta.

Shërbimet e urgjencës në Slloveni, Kroaci, Bosnjë dhe Serbi u përpoqën më 20 korrik ta rivendosin energjinë elektrike dhe t'i pastrojnë mbeturinat e mbetura pas kaosit të një dite më parë.

Meteorologët thanë se stuhia ishte jashtëzakonisht e fuqishme

pasi u formua pas një vargu ditësh shumë të nxehta.

Më herët, në kryeqytetin e Kroacisë, Zagreb, janë raportuar dy viktima si pasojë e stuhisë. Sipas policisë kroate, dy burra humbën jetën pasi u goditën nga rrëzimi i pemëve. Ngjarja përfshinte një 50-vjeçar që ndodhej jashtë në rrugë dhe një 48-vjeçar që ndodhej brenda makinës së tij gjatë fatkeqësisë.

Mjekja e urgjencës, Ljupka Hitrova, ka bërë me dije për agjencinë zyrtare të lajmeve "Hina" se të dy viktimat kanë pësuar lëndime të rënda në kokë.

Në Cernik të Kroacisë një person tjetër humbi jetën sa ishte në makinën e tij, gjithashtu nga rrëzimi i një pemë. Diku tjetër në Zagreb, një 36-vjeçar u lëndua rëndë kur një vinç pranë një zone ndërtimi u shemb, thuhet në deklaratën e policisë.

Stuhia errësoi të mërkurën papritur qiellin dhe solli shi,



përmbytje të shpejta dhe erëra në të gjithë Zagrebin duke filluar rreth orës 16:00.

Transporti i qytetit u ndal, pati ndërprerje të energjisë elektrike

dhe rrugët u bllokuan për shkak të pemëve të rrëzuara.

Shërbimet e urgjencës së Zagrebit u kërkuan qytetarëve të kenë durim, pasi qindra thirrje për ndihmë erdhën menjëherë. "Ne u bëjmë thirrje qytetarëve që të thërrasin vetëm nëse janë në një situatë kërcënuese për jetën deri në stabilizimin e situatës", tha kryetari i bashkisë së Zagrebit, Tomislav Tomaseviq në "Twitter".

Një situatë e ngjashme u raportua në Slloveni, ku era e fortë rrëzoi pemë dhe dëmtoi çati.

Transmetuesi publik "RTV Sllovenia" raportoi se një person humbi jetën dhe një tjetër u lënduar kur një pemë ra mbi ta në zonën e liqenit Bled.

Një person humbi jetën në Bosnjë dhe të paktën 20 u lënduan, thanë autoritetet atje. Autoritetet në Serbi lëshuan

paralajmërimet për qytetarët, ndërsa stuhia u zhvendos drejt lindjes.

Erërat e forta u përhapën nëpër kryeqytetin serb të Beogradit, të mërkurën në mbrëmje.

Disa pjesë të qytetit mbetën pa energji elektrike dhe aeroporti i Beogradit u mbyll për kohësisht. Një video e postuar në rrjetet sociale tregon një vinç të madh duke rënë. Diku tjetër në Serbi, banorët raportuan pemë të çara në mes, tulla që binin dhe çati të dëmtuara.

Një vajzë 12-vjeçare u shtrua në spital pasi një pemë ra mbi të në qytetin verior të Novi Sadit, thanë mjekët.

Shërbimet e urgjencës në të tre vendet raportuan qindra ndërhyrje ndërsa stuhia përfshiu rajonin. Autoritetet paralajmëruan alpinistët të qëndrojnë larg atyre zonave me pemë.



Sulmohet ambasada suedeze në Bagdad në shenjë proteste për djegien e Kuranit

BAGDAD, 20 KORRIK - Qindra protestues sulmuan ambasadën suedeze në qendër të Bagdadit në orët e hershme të mëngjesit të së enjtes, duke u ngjitur në muret e saj dhe duke i vënë flakën në shenjë proteste kundër djegies së Kuranit në Suedi.

I gjithë personeli i Ambasadës në Bagdad mbeti i padëmtuar gjatë incidentit, siç konfirmohet nga zyra e shtypit e Ministrisë së Jashtme suedeze në një deklaratë për medie.

Ministria dënoi me forcë sulmin dhe theksoi rëndësinë e marrjes së masave të nevojshme nga autoritetet irakiane për t'i mbrojtur misionet diplomatike. Megjithatë, ministria nuk iu

përgjigj menjëherë një kërkesë të agjencisë së lajmeve "Reuters" për informacion shtesë në lidhje me situatën.

Mbështetësit e klerikut shiit Muqtada Sadr organizuan protestën të enjten kundër djegies së dytë të planifikuar të Kuranit në Suedi brenda pak javësh.

Njoftimi për protestë u bë përmes postimeve në një grup në Telegram të ndjekur gjerësisht, që është i lidhur me klerikun me ndikim, si dhe në kanale të tjera mediatike që e mbështetnin atë.

Si një nga figurat më me ndikim të Irakut, Sadr ka ndikim mbi një numër të madh ndjekësish të



përbërë nga qindra mijëra mbështetës.

Ai ka thirrur më parë ndjekësit e tij për të dalë në rrugë në raste të

ndryshme, si në verën e kaluar kur ata pushtuan Zonën e Gjellbër të fortifikuar të Bagdadit, duke çuar në konfrontime fatale.

Sipas lejes së lëshuar nga policia suedeze të mërkurën, një tubim publik jashtë Ambasadës së Irakut në Stokholm u miratua.

Leja tregonte se vetëm dy persona pritej të merrnin pjesë në këtë tubim. Një nga ta është një burrë që i vuri zjarrin Kuranit jashtë një xhamie të Stokholmit në qershor.

Policia suedeze refuzoi disa aplikime për protesta në fillim të këtij viti, që do të përfshinin djegien e Kuranit, duke përmendur shqetësimet e sigurisë.

Gjykatat që atëherë kanë rrëzuar vendimet e policisë, duke thënë se akte të tilla mbrohen nga ligjet e gjera të vendit për lirinë e fjalës.

Hovenieri: E mbështetim FSK-në teksa transformohet në forcë mbrojtëse territoriale ndërvepruese me NATO-n

PRISHTINË, 20 KORRIK - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Jeff Hovenier, ka pritur në Ambasadën e ShBA-së në Prishtinë ushtarin e FSK-së, Ylli Dalladaku, i cili ka përfunduar një prej

kurseve ushtarake amerikane që është prej më rigorozeve. Dalladaku ka përfunduar kursin e Shkollës Ushtarake të West Point, duke u bërë kështu ushtari i parë i FSK-së që kalon në

Akademinë Amerikane. Hovenieri ka thënë se ShBA-ja e mbështet FSK-në teksa transformohet në një forcë shumetnike, profesionale dhe forcë e mbrojtjes territoriale e ndërvepruese me NATO-n.



Përfundon dëshminë dëshmitari i 15-të, gjykimi ndaj Thaçit dhe të tjerëve rinis më 14 gusht



HAGË, 20 KORRIK - Në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë, me përfundimin e dëshmisë së dëshmitarit të 15-të me radhë (me kodin 04586), gjykimi ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit do të rinisë më 14 gusht 2023.

Dëshmitari me kodin 04586 ka dëshmuar të enjten përmes videolidhjes, raporton "Betimi për Drejtësi".

Duke qenë se ekipet e mbrojtjes nuk kanë pasur pyetje për këtë dëshmitar, seanca ka vazhduar me pyetjet e trupit gjykues.

Me pyetje ka filluar anëtari i trupit gjykues, gjykatësi Guenaël Mettraux, i cili e ka pyetur atë nëse i kishte raportuar dikujt atë që i kishte ndodhur anëtarit të familjes së tij, e që dëshmitari u përgjigj me "po".

Ndërkaq, kur u pyet se kujt ia

kishte treguar këto ngjarje, DhSK-ja ka vendosur që përgjigja e dëshmitarit të ketë përmbajtje të redaktuar dhe kështu ka mbetur edhe pjesa tjetër e përgjigjeve të tij.

Më tej, një pjesë e shkurtër e deklarimit të tij ka qenë në seancë publike, por që ka qenë e pamundur të kuptohen plotësisht deklarimet e dëshmitarit.

Në këto rrethana dëshmia e tij ka përfunduar dhe se gjykimi për këtë çështje gjyqësore do të rinisë më 14 gusht, pas pushimit të Gjykatës Speciale, me dëshmitarët e radhës.

Kryetari i trupit gjykues, gjykatësi Charles Smith, paraprakisht tregoi se të akuzuarit Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi kanë hequr dorë nga prania e tyre në sallë për këtë seancë dhe të njëjtën e kanë përcjellë përmes videolidhjes.

Konjufca në Francë: Arritjet e shtetit tonë, suksese edhe të aleatëve tanë

PRISHTINË, 20 KORRIK - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, në kuadër të vizitës zyrtare në Francë, shoqëruar nga ambasadori Mehdi Halimi, shefi i stafit Ilir Kërçeli dhe këshilltari Donik Sallova, zhvilloi takime me drejtues të lartë të parlamentit francez.

Konjufca u prit në takim nga kryetarja e Asamblesë Kombëtare të Francës, Yaël Braun-Pivet, nënkryetarja e Asamblesë Kombëtare, Valerie Rabault, kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme, Jean-Louis Bourlanges, deputeti për francezët që jetojnë jashtë Francës, Frederic Petit dhe kryetari i Grupit të Miqësisë Francë - Kosovë, Jean-Philippe Arduin.

Në këtë takim miqësor u theksua nevoja për thellim të bashkëpunimit midis dy vendeve aleate si në rrafshin e raporteve mes institucioneve parlamentare, ashtu edhe në nivel të plotë shtetëror.

Konjufca theksoi se Republika e Kosovës është shumë e interesuar që partneriteti mes dy vendeve të jetë jo vetëm i vazhdueshëm dhe i palëkundur, por edhe të thellohet më tej duke lëvruar gjithë potencialin e vet nga pikëpamja institucionale, kulturore, ekonomike dhe politike.

Ai falënderoi homologen franceze Yaël Braun-Pivet për kontributin e Francës në drejtim të Kosovës ndër vite, asistencën e vyer që Kosovës i ka sjellë sot sukses në cilësitë e shtetndërtimit, në sundim të ligjit dhe demokratizimin shembullor në rajon. "Arritjet e shtetit tonë janë edhe suksese të aleatëve tanë që na kanë mbështetur dhe kanë dhënë kontributin e tyre e ndaj të cilëve ne jemi mirënjohës", ka theksuar Konjufca.

Gjatë diskutimit lidhur me situatën aktuale në Kosovë dhe sfidat që ajo ka para vetes, kreu i Kuvendit theksoi përkushtimin



e plotë të Republikës së Kosovës ndaj angazhimeve të saj që në

vëmendje kanë shembullin, mjetet dhe frymën e Bashkimit

Evropian, unionit të vlerave dhe qëllimeve të përbashkëta.



Rreth 57 për qind e familjeve në Kosovë nuk kanë mundësi të bëjnë pushime verore

Përfaqësues të bizneseve, të cilat bëjnë oferta për pushime jashtë Kosovës, thonë se çmimi i tyre është rritur për së paku 15 për qind më shumë se një vit më parë. Të dhënat e fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës tregojnë se çmimet e larta të produkteve të konsumit të përditshëm dhe të shërbimeve të tjera, përballë nivelit të pagave në vend, ua pamundësojnë rreth 57 për qind të familjeve në Kosovë përballimin e një pushimi njëjavor, qoftë në det apo diku tjetër.

Prishtinë, 20 korrik - "Është viti i pestë që unë nuk mund të shkoj në pushime me familjen time për shkak se nuk arrijmë t'i tubojmë paratë", thotë Florim Beqiri, shitës i librave në një kioskë në Prishtinë.

Të dhënat e fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës tregojnë se çmimet e larta të produkteve të konsumit të përditshëm dhe të shërbimeve të tjera, përballë nivelit të pagave në vend ua pamundësojnë rreth 57 për qind të familjeve në Kosovë përballimin e një pushimi njëjavor, qoftë në det apo diku tjetër.

Shifra bazohet në rezultatet e anketës mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës në vitin 2021.

Profesori i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Nagip Skenderi, vlerëson se shifra mund të jetë edhe më e lartë sivjet, marrë parasysh rritjen e

vazhdueshme të çmimeve të produkteve të konsumit.

Nga viti 2012 deri në vitin 2022, pesë nga produktet ushqimore bazike në Kosovë - buka, qumështi, vezët, vaji dhe sheqeri - u shtrenjtuan deri mbi 0.50 euro. Në vitin 2022 norma e inflacionit ishte më e lartë për 9.1 për qind, krahasuar me vitin 2012. Përfaqësues të bizneseve, të cilat bëjnë oferta për pushime jashtë Kosovës, thonë se çmimi i tyre është rritur për së paku 15 për qind më shumë se një vit më parë.

Pushime të reduktuara ose fare

Florim Beqiri thotë se ai dhe bashkëshortja e tij janë të punësuar, por se nuk arrijnë të ndajnë të holla për të siguruar një pushim të shkurtër në det. "Çmimet, posaçërisht të

ushqimit, janë shtrenjtuar në masë shumë të madhe, por edhe banimi është shtrenjtuar. Për sivjet e kemi 'fshirë' detin", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Mërgim Bektoshi punon në sektorin publik, ashtu sikurse edhe bashkëshortja e tij. Ai thotë se vitin e kaluar nuk kanë mundur të bëjnë pushime, ndërsa sivjet planifikojnë të shkojnë në bregdetin e Shqipërisë, por për kohë të shkurtër. "Në mungesë të mjeteve ndoshta do të jetë për kohë më të reduktuar. Një ose dy ditë, jo më shumë. Kjo është e tëra. Jeta është bërë shumë e shtrenjtë. Këto çmime janë të papërbalueshme me paga nga sektori publik. Kjo është arsyeja", thotë Bektoshi.

Destinacione më të shpeshta pushimesh për qytetarët e Kosovës janë bregdeti i Shqipërisë dhe ai i Malit të Zi.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, paga mesatare bruto në vend, për dhjetë vjet, është rritur 138 euro. Nga 383 euro sa ka qenë në vitin 2012, ajo është bërë 521 euro në vitin 2022.

Vitin e kaluar, ndërkaq, Kosova e ka përmbyllur me normë mesatare të inflacionit gati 12 për qind.

Profesori i ekonomisë, Nagip Skenderi, thotë se kjo normë përfshin gjithë nivelin e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve në treg.

Në këtë kontekst, sipas tij, realitetet ekonomike ndryshojnë kur bëhet fjalë për produktet bazike apo ato që përbëjnë shportën familjare. "Për shembull, prej vitit 2022 deri në vitin 2023 në disa produkte kemi ngritje të çmimeve për 60 deri në 70 për qind. Prandaj, realitetet ekonomike me ato statistikore tash ndryshojnë. Qytetarët orientohen t'i plotësojnë elementet bazike, t'i paguajnë qiratë, t'i paguajnë kreditë hipotekare, mandej t'i paguajnë shërbimet komunale. Në këtë kontekst pushimi mbetet në dorë të dytë ose si një nga objektivat e dyta", thotë Skenderi.

Ngritje e çmimeve të ofertave për pushime

Agjencitë turistike në Kosovë, përmes rrjeteve sociale dhe në forma të tjera, reklamojnë gjatë gjithë vitit oferta për udhëtime dhe pushime jashtë vendit. Por, këto oferta, sivjet, janë më të shtrenjta se një vjet ose dy vjet më parë. Këtë e konfirmon për Radion Evropa e Lirë edhe Shpëtim Turku, drejtor i agjencisë "Fibula" në Kosovë, e cila merret me organizimin e udhëtimeve. "Minimumi i ngritjes së çmimeve është 15 për qind [krahasuar me vitin paraprak]. Ka disa hotele që shkojnë deri në 50 për qind dhe 70 për qind [më shtrenjtë]. Varet prej kategorisë së hoteleve dhe prej vendit në rajon dhe në përgjithësi ku ne i dërgojmë, në Turqi, Dubai, Maldive etj.", thotë Turku.

Ai shton se, ndër vendet e rajonit, Kroacia i ka shtrenjtuar ofertat deri në 50 për qind, ndërsa Mali i Zi deri në 30 për qind.

Shtrenjtimit të ofertave, sipas tij, ka edhe në Shqipëri për shkak të forcimit të monedhës së këtij shteti në krahasim me euron. Aktualisht 1 euro këmbëhet me

PDK-ja e çon në Kushtetuese vendimin e Konjufcës për seancën ku u votua edhe Ligji për Pagën Minimale

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 20 KORRIK - Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, ka bërë me dije se në emër të partisë e kanë çuar në Gjykatë Kushtetuese vendimin e kryetarit të Kuvendit të Kosovës për caktimin e seancës plenare të javës së kaluar. “Në emër të grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, ju njoftoj se kemi kontestuar në Gjykatën Kushtetuese vendimin për caktimin e Seancës Plenare të javës së kaluar. Si palë e autorizuar pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës kemi parashtruar kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit për caktimin e Seancës Plenare të datës 13 korrik 2023 të

kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me kërkesën që i njëjti në tërësi të anulohet”, ka shkruar Tahiri në “Facebook”.

Ai ka thënë se seanca e fundit plenare e Kuvendit ishte caktuar dhe ftuar në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit prandaj, si e tillë, duhet të anulohet dhe, bashkë me të, edhe të gjitha vendimet që janë marrë në këtë seancë jokushtetuese. “Si parashtrues të këtij rasti, vlerësojmë se kryetari i Kuvendit ka bërë shkelje kushtetuese në dy drejtime: e para, në mospërmbushjen e afatit për thirrjen dhe caktimin e seancës plenare dhe, e dyta, duke mos e vendosur për miratim rendin e ditës të kësaj seance - në mungesë të konsensusit të

Kryesisë si rezultat i mungesës së kuorumit të nevojshëm, përkatësisht dështimit të mbajtjes së mbledhjes së Kryesisë. Si i tillë, ky vendim ka prodhuar pasoja kushtetuese dhe ligjore sepse ka rezultuar me mbajtjen e seancës plenare të ftuar sipas një procedure jokushtetuese, në të cilën janë miratuar ligje dhe projektligje si dhe vendime të tjera për zgjedhjen/shkarkimin e bartësve të institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të pavarura”, ka thënë Tahiri. Ai ka thënë se krahas kërkesës për anulimin e kësaj seance dhe vendimeve që janë marrë në të, kanë kërkuar edhe masë të përkohshme, që deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, të pezullohet efekti i të gjitha vendimeve që kanë rezultuar nga kjo seancë jokushtetuese.



Ambasadorit të BE-së i zgjatet mandati në Kosovë edhe për një vit



Prishtinë, 20 korrik - Këshilli Evropian ka njoftuar se ia ka zgjatur edhe për një vit mandatin shefit të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog. Sipas njoftimit të së enjtes, mandati i ri i Szunyog do të përfundojë më 31 gusht 2024. Ai ishte emëruar si Përfaqësues Special i BE-së për Kosovën

më 1 shtator 2020. Mandati i tij përfshin detyrën e ofrimit të këshillave dhe mbështetjes së BE-së në procesin politik dhe promovimin e koordinimit të përgjithshëm politik të Unionit në Kosovë. Përveç Szunyog, Këshilli Evropian ia ka vazhduar mandatin edhe për një vit Johann Sattlerit në Bosnjë-

Hercegovinë, ndërsa Toivo Klaar u emërua për Kaukazin e Jugut. Përfaqësuesit Specialë të BE-së propozohen nga Përfaqësuesi i Lartë, Josep Borrell, për t'i promovuar politikën dhe interesat e BE-së në rajone dhe vende të veçanta si dhe për t'i siguruar BE-së një prani politike aktive në ato zona.

rreth 100 lekë. Në muajin prill të këtij viti, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, një euro këmbuhej me rreth 120 lekë.

Mërgimtarët ua mësyjnë bregdeteve

Gjatë muajve të verës agjencitë turistike në Kosovë frekuentohen mjaft edhe nga mërgimtarët, të cilët kthehen nga diaspora për një pjesë të pushimeve në Kosovë.

Disa thonë se ngritja e çmimit të ofertave për pushime është normale, marrë parasysh rritjen e inflacionit.

Bedri Zymberi, i cili jeton dhe punon në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, thotë se fillimisht i ka rezervuar pushimet në Shqipëri por, për shkak të ngritjes së çmimeve atje, ka vendosur të shkojë në Turqi, bashkë me familjen e tij. “E anulua Shqipërinë dhe do të shkojmë në Turqi. Dallimi nuk ishte shumë i madh dhe ne morëm ofertën ‘all inclusive’ [gjithëpërfshirëse]. Për Turqi, një familje me pesë anëtarë duhet të sigurojë rreth katër ose pesë mijë [euro], varësisht nga hoteli”, thotë Zymberi.

Ilaz Sinani, i cili jeton dhe punon në Belgjikë, thotë se një pjesë të pushimeve do ta kalojë në Kosovë, ndërsa disa ditë në Shëngjin të Shqipërisë. “Në Shëngjin, unë e paguaj 150 euro [për një natë] hotelin, me mëngjes, për mua, bashkëshorten dhe dy fëmijët e mi që janë të moshës madhore. I bie 900 euro për gjashtë net”, thotë Sinani.

Drejtori i agjencisë “Fibula”, Shpëtim Turku, thotë se kërkesat e qytetarëve të Kosovës për ofertat për pushime këtë vit kanë shënuar rënie. Për shkak të ngritjes së çmimeve të ofertave, sipas tij, ka rënë edhe kërkesa për kualitetin e akomodimit. “Viti 2021 ka qenë më i mirë, sepse pas [pandemisë] Covid-19 njerëzit, mbase, kanë akumuluar para dhe inflacioni nuk ka ndikuar shumë. Edhe viti 2022 ka qenë i mirë. Por, sivjet, vërehet shumë [rënia e interesimit], në krahasim me vitet e kaluara”, thotë Turku.

Sipas të dhënave të ASK-së, të publikuara në korrik, indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ka qenë më i lartë për 2.8 për qind në qershor të këtij viti krahasuar me muajin qershor të vitit 2022.

Shqipëria turistike vazhdon të bëjë bujë ndërkombëtarisht

Media amerikane “The Travel of Path” i ka dedikuar një artikull bregdetit të bukur shqiptar, i cili s’është më surprizë të quhet “Maldivet e

Europës” në Shqipërinë tonë që po thyen rekorde turistike siç konfirmohet edhe nga Organizata Botërore e Turizmit dhe që e ka

gjithmonë ftesën e hapur për të zbuluar shumëçka duke nisur nga plazhet, fshatrat piktoreske e plot monumente historike.



10 mijë udhëtarë më shumë prej biletave ditore në kryeqytet

PRISHTINË, 20 KORRIK - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se 10 000 udhëtarë më

shumë po përdorin autobusët e trafikut urban, si rezultat i vendimit të marrë në muajin janar të këtij viti për përdorimin

e biletës ditore, 0.80 centë. Ai ka thënë se shumë shpejt flotës së trafikut urban do t'i shtohen edhe 30 autobusë të rinj, 6 prej

të cilëve do të jenë elektrikë. "Kjo do t'i përmirësojë shërbimet e ofruara për qytetarët", ka thënë Rama.



Komuna e Skenderajt binjakëzohet me komunën e Vukovarit

SKENDERAJ, 20 KORRIK - Komuna e Skenderajt është binjakëzuar me komunën e Vukovarit në Kroaci. Lajmin e ka dhënë kryetari i Skenderajt, Fadil Nura. "Me mikun Ivan

Penava, kryebashkiak i Vukovarit, me të cilin po hapim një etapë të re bashkëpunimi në fusha të shumta, nëpërmjet binjakëzimit të Skenderajt dhe

Vukovarit, që ndajnë vlera të përbashkëta me veçantinë e pikënisjes së luftës për lirinë e dy popujve në dy qytetet tona", ka shkruar Nura në "Facebook".

Rreth 480 mijë euro subvencione shtesë për sektorin e bujqësisë në Gjilan

GJILAN, 20 KORRIK - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka nënshkruar një memorandum të bashkëfinancimit me drejtorin Islamic Relief Kosova, dr. Mohamed Soliman. Memorandumi kap vlerën e afro 480 mijë euro dhe mjetet do të

shkojnë për subvencione shtesë për sektorin e bujqësisë. "22 serra nga 500m2, 30 panele diellore për fermerët, 120 lopë qumështore do të shpërndahen për fermerët përfitues. Ashtu siç jemi zotuar, bujqësia do të jetë një ndër sektorët më të zhvilluar në Gjilan", është shprehur kryetari Hyseni.



Përrurohet Qendra e Mjekësisë Familjare në Frashër



MITROVICË, 20 KORRIK - Është bërë përrurimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në fshatin Frashër, bashkëfinancim i komunës së Mitrovicës dhe organizatës "Qatar Charity". Me rastin e përrurimit të kësaj QMF-je, morën pjesë kryetari i komunës, Bedri Hamza, nënkryetari i komunës, Arian Tahiri, drejtori i organizatës "Qatar Charity", Esam Dabab, drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi, Fahri Shabani, drejtor të drejtorive komunale, asamblistë, drejtori i QKMF-së "Dr. Nexhat Çuni", Fevzi Sylejmani. Kjo qendër mjekësore me një ambient tejet modern, punimet e të cilës kanë mbaruar sipas planit dinamik, do të jetë në shfrytëzim për banorët e Frashërit dhe rrethinës, të cilët tani e tutje do të marrin

shërbime efikase në hapësira me standarde të larta e kualitative. Në fjalimin e tij, kryetari i komunës, Bedri Hamza, tha se çdoherë është kënaqësi për të kur përruron punë të mira, e sidomos në sektorin e shëndetësisë ku, sipas tij, dy prioritetet kryesore pa i nënvlerësuar të tjerat janë arsimit dhe shëndetësia. "Sot po e promovojmë Qendrën e Mjekësisë Familjare në Frashër me qëllim që të jemi sa më afër qytetarëve dhe të ofrojmë shërbime sa më cilësore. Sa i përket infrastrukturës dhe objekteve shëndetësore, jam i sigurt që asnjëherë prej që ekziston shëndetësia primare në Mitrovicë nuk ka pasur kaq shumë investime nga ana e komunës", është shprehur Hamza.

Asfaltohen tri akse rrugore në lagjen "Arbana" në Prizren

Prizren, 20 korrik - Komuna e Prizrenit, në kuadër të përfundimit të punimeve në projektin "Ndërtimi i infrastrukturës në lagjen

Arbana", ka asfaltuar tri akse rrugore (1050m). Kryetari i kësaj komune, Shaqir Totaj, ka njoftuar se këto akse rrugore do të

shërbejnë për banorët e kësaj lagjeje të madhe në hyrje të qytetit të Prizrenit. "Rëndësia e ndërtimit dhe rregullimit të rrugëve në gjithë

Komunën e Prizrenit është e madhe, pasi, infrastruktura moderne ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik", ka shkruar Totaj në "Facebook".



Hovenieri takon Krasniqin: Zgjedhjet e parakohshme, alternativa e vetme

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 KORRIK - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka pritur në selinë e partisë ambasadorin e ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier. Krasniqi ka bërë me dije se situata aktuale politike, qëndrimet e PDK-së në raport me to dhe veprimet e nevojshme përpara, drejt rikthimit të Kosovës në kursin pa alternativë euroatlantike, ishin tema të diskutimit me ambasadorin amerikan. "Për PDK-në, siç kemi thënë nga fillimi, veprimet e njëanshme dhe të pakoordinuara të Qeverisë së Kosovës, të cilat përtej dëmtimit të progresit dhe imazhit të vendit, i sollën

Kosovës edhe sanksione nga partnerët kryesorë ndërkombëtarë, janë tërësisht të papranueshme. Ky nuk është vullneti i qytetarëve dhe ajo për të cilën ata kanë votuar, rrjedhimisht, ambasadorit amerikan i shpreha qëndrimin që Kosova të mos vuajë masa ndëshkuese për shkak të kryeneçësisë politike të një individi", ka thënë Krasniqi pas takimit.

Ai ka theksuar se PDK-ja vlerëson se kjo qeveri e ka humbur rrugën e duhur, njëkohësisht edhe kredibilitetin e saj, prandaj thotë se zgjedhjet e parakohshme janë alternativa e vetme. "Ambasadorin amerikan e falënderova për përkushtimin e tij të jashtëzakonshëm në interes të shtetit dhe qytetarëve



tanë dhe e sigurova se PDK-ja do të angazhohet fuqishëm që përmes të gjitha mjeteve demokratike, ta luaj rolin konstruktiv në shërbim të këtij interesi", ka deklaruar Krasniqi.

Haradinaj: Është koha e fundit që Kurti të largohet nga temat tensionuese dhe destruktive

PRISHTINË, 20 KORRIK - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se Kurti mund të ketë ritmin dhe orën e tij, por Kosova nuk ka kohë të humbë. Haradinaj në "Facebook" ka shkruar se është koha e fundit kur Kurti t'i lexojë drejt porosinë e miqve dhe të largohet nga temat tensionuese. "Është koha e fundit që Kurti t'i lexojë drejt porosinë e miqve të palëkundur të Republikës së Kosovës, të Komisionit të Dhomës së Përfaqësuesve për Marrëdhëniet me Jashtë, të ofruara me dashamirësinë dhe mirëkuptimin



e aleatëve dhe partnerëve në dëshminë e fundit të Escobarit. Është koha e fundit që Kurti të largohet nga temat tensionuese dhe destruktive, ku vegjetojnë

liderët pro-rus, sikurse janë dhe do të vazhdojnë të mbesin Dodik dhe Vuçiq", është shprehur Haradinaj. Haradinaj ka shtuar se ShBA-ja

edhe këtë herë po e inkurajon Kosovën t'u qëndrojë zotimeve dhe t'i hapë rrugë afirmimit ndërkombëtar. "Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe politikëbërësit e saj, edhe kësaj radhe po inkurajojnë Kosovën t'u qëndrojë zotimeve, të hapë rrugë për afirmim ndërkombëtar, për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, për fushatë globale të njohjes, për avancim në integrim evropian dhe për zhvillim social e ekonomik, për vendosmëri në proces të rrugëtimit drejt NATO-s dhe BE-së. Këtu qëndrojnë, këtu i gjejmë dhe këtu na presin miqtë tanë

strategjikë", ka thënë Haradinaj. Haradinaj ka thënë se Kurti mund ta ketë ritmin dhe orën e tij, por Kosova nuk ka kohë për të humbur. "Kosova e ka për detyrim ta bëjë pjesën e saj dhe ta përqafojë mbështetjen e pazezervë të ShBA-së dhe aleatëve, në mbylljen e plasaritjeve dhe shtigjeve të ndërhyrjeve nga Rusia dhe Kina në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Kurti mund ta ketë ritmin dhe orën e tij, por Kosova nuk ka kohë të humbë, veçmas kur porosinë dhe pritjet e aleatit tonë janë të qarta dhe të drejtpërdrejta. Koha është tash!", ka përfunduar Haradinaj.

FSK-ja, e gatshme për pjesëmarrje në misione të përbashkëta me ushtrinë amerikane

PRISHTINË, 20 KORRIK - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Bashkim Jashari, me ftesë të gjeneralit Daniel R. Hokanson, shef i Byrosë së Gardës Kombëtare të ShBA-së, qëndroi në Uashington DC për konferencën e shënimit të 30-vjetorit të themelimit të Programit të Partneritetit Shtetëror (State Partnership Program-SPP) të Gardave Kombëtare. Në suaza të konferencës mbi 800 të pranishmëve iu adresua gjeneral Mark A. Milley, shef i Shtabit të Përbashkët (Chairman of the Joint Chiefs of Staff), ku, KOMFSK gjatë konferencës pati mundësinë edhe të takojë me të. Në kuadër të konferencës KOMFSK, së bashku me homologun nga GK e Iowas gjeneral Osborn, patën rastin të zhvillojnë takime të rëndësishme në funksion të bashkëpunimit dhe aktiviteteve në kuadër të SPP-së.

Gjeneral Jashari dhe homologu i tij nga Iowa patën takim me gjeneraljejtënant Steven Basham, zëvendëskomandant i EUCOM-it dhe ambasadorin Kate Byrnes, këshilltare për Politika të Jashtme në EUCOM. "Gjeneral Jashari shfrytëzoi rastin t'i falënderojë ShBA-në dhe EUCOM-in për përkrahjen e vazhdueshme për Kosovën dhe FSK-në, dhe i njoftoi për sukseset dhe arritjet e përbashkëta me partnerin tonë, Iowan. Gjeneral Jashari konfirmoi gatishmërinë e FSK-së për pjesëmarrje në misione të përbashkëta me ushtrinë amerikane dhe në aktivitete e trajnime të tjera në funksion të mbajtjes dhe zhvillimit të aftësive të ndërveprimit me forcat partnere", ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes.

Sipas këtij njoftimi, gjenerali Basham dhe ambasadorja Byrnes falënderuan gjeneral Jasharin dhe gjeneralin Osborn dhe



konfirmuan vullnetin e EUCOM-it për mbështetje dhe përkrahje për Forcën e Sigurisë së Kosovës. "Konferenca shënoi një

përmbledhje të suksesshme të programit të SPP-së mbi arritjet gjatë 30 viteve dhe u shpalos vizioni për të ardhmen. Kosova

dhe FSK-ja do të qëndrojnë të palëkundura në partneritetin me ShBA-në", ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes.

Kurti bashkëbisedon me bizneset për identifikimin e profileve të nevojshme

PRISHTINË, 20 KORRIK - Pas bashkëbisedimit me bizneset nga sektori i drurit dhe mobileve, kryeministri Albin Kurti të enjten pati edhe një bashkëbisedim tjetër me bizneset nga sektori i ushqimit dhe pijeve për identifikimin e profileve të nevojshme të arsimit dhe aftësisht profesional kundrejt nevojave të tregut të punës.

Pasi i falënderoi ata për angazhimin dhe kontributin që e bëjnë përditë tash e shumë vjet, tha se është kënaqësi të diskutojnë për një çështje shumë të rëndësishme, edhe për biznesin në Kosovë dhe ekonominë, gjithashtu edhe

për qeverisjen e mirë demokratike. “Një ndër projektet kryesore në ekonomi që i ka qeveria jonë, e që do të transformojë këtë sektor, është arsimit dhe aftësimi profesional, përkatësisht arsimit dual, përmes të cilit do të synohet që për një diplomë në shkollat tona duhet të sigurojmë një vend pune në ekonominë tonë. Në këtë drejtim ai nënvizoi se bashkëpunimi ndërmjet qeverisë dhe biznesit është i nevojshëm. Lidhja midis arsimit dhe ekonomisë sot është vendimtare se çfarë shteti, ekonomie do të kemi në vitet në vijim të kësaj dekade dhe jo vetëm”, shtoi

ai. Sektori i pijeve dhe i ushqimit përbën fushë shumë të rëndësishme të biznesit vendor, u shpreh kryeministri, duke shtuar se në performancën industriale, ka rezultuar që sektori i pijeve dhe i ushqimit, pastaj përpunimit të drurit e të metaleve, gomës e i plastikës, i mineraleve jometalike, i produkteve metalike dhe i metaleve bazë, por edhe sektorët, si i tekstilit, veshjeve dhe i lëkurës, janë sektorë, të cilët e bëjnë një pjesë të madhe të punësimit në Kosovë dhe që po kanë rritje nga viti në vit, nga muaji në muaj madje.



Më tej, kryeministri tha se sipas interesimit të shprehur nga vetë komunat dhe shkollat, në vitin shkollor 2023/2024, në 21 shkolla profesionale në 13 komuna do të ofrohen 8 profile

shtesë, e ato janë: rrobaqepës, automekanik, përpunues i metalit, përpunues i drurit, instalues i ngrorjes dhe klimatizimit, instalues elektrik, tregtar me shumicë dhe pakicë, estetist.

KMDLNj: ZRRE-ja dinte t'i plaçkiste qytetarët, tash nuk di si t'i kompensojë!

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 KORRIK - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se ZRRE-ja pas përfundimit të luftës, që nga koha kur u themelua, ishte keqbërësi dhe dhunuesi më i madh i buxhetit familjar si dhe i bizneseve duke përligjur vjedhjen klasike përmes fryrjes së faturave me ç'rast e pësonin paguesit e rregullt të energjisë elektrike, ndërsa përfitonin qytetarët e veriut të Kosovës që deri më sot nuk e kanë paguar asnjë cent për rrymën e shpenzuar. “Mjetet e grumbulluara përmes veprës penale (vjedhjes përmes fryrjes së faturave) ndaheshin për strukturat paralele në veri ku lulëzonte biznesi me kriptovaluta dhe kultivimi i lëndëve narkotike për çka duhej një sasi e madhe e rrymës. Pas ankesave të shumta të qytetarëve, KMDLNj ka reaguar rregullisht për të sinjalizuar këtë plaçkitje të kundërligjshme duke kërkuar që të ndërpritet me këtë praktikë të mbrapshtë dhe të bëhet zhdëmtimi i qytetarëve për dëmet e shkaktuara. Fillimisht nga ZRRE-ja dhe



operatori mohojë ky veprim i kundërligjshëm deri në kohën kur edhe Avokati i Popullit bëri një reagim duke e dërguar lëndën në Gjykatën Kushtetuese. Komisioni përkatës parlamentar pati konstatuar se ka shkelje mirëpo nuk kishte bërë asgjë ta ndërprisë plaçkitjen dhe të propozojë masa kundër keqbërësve”, ka theksuar KMDLNj. Përveç kësaj, KMDLNj ka bërë me dije se të gjitha qeveritë e pasluftës, përfshirë edhe qeveritë Kuri 1 dhe Kurti 2, kanë ndarë mjete të konsiderueshme, dhjetëra miliona euro brenda një viti kalendarik për ta paguar rrymën për veriun e Kosovës. “Qytetarët e veriut të Kosovës

përveç rrymës nuk kanë paguar as faturat e ujit, mbeturinave e as tatimin në pronë e që nuk i paguajnë as sot e kësaj dite. KMDLNj në një takim pati kërkuar nga kryeministri Haradinaj që të ushtrojë autoritetin dhe ta ndërprisë pagesën e rrymës për veriun e Kosovës sikur që qytetarët e Kosovës, pagues të rregullt të kompensohen për dëmet e shkaktuara. Ishte një lëvizje e vogël por që shpejtë u harrua duke vazhduar me praktikën e vjetër, pagesën e rrymës për veriun nga Buxheti i Kosovës ndërsa fryrja e faturave ishte ndërprerë”, thuhet në reagimin e KMDLNj-së. Më tutje, KMDLNj ka theksuar se së fundi Gjykata Supreme e

Kosovës mori vendim që ZRRE-ja të urdhërojë operatorin aktual të energjisë elektrike t'i kompensojë qytetarët e dëmtuar për mjetet e plaçkitura dhe Rregullatori i Energjisë Elektrike për të fituar kohë, me një mentalitet prej kusari që e kishte përdorur gjatë tërë këtyre viteve, po përpigjet të gjejë mënyra ta shmangë pagesën e kompenimit duke deklaruar se për faktin se nuk e kanë të qartë se si duhet të kompensohen qytetarët, e kanë dorëzuar një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me të cilën kërkohen sqarime se si do të kompensohen qytetarët. Blerje tipike e kohës. “ZRRE është njëri ndër shkelësit më të mëdhenj të të drejtave të njeriut në Kosovës dhe praktikuesi më i madh i diskriminimit për faktin se qytetarët e Kosovës nuk i trajton si konsumatorë që duhet të paguajnë për rrymën e shpenzuar por i keqtrajton ekskluzivisht në baza etnike dhe sipas oportunitetit politik. Blerja e kohës nënkupton se qytetarët do të lodhen nga kërkesa e tyre e drejtë për kompenzim dhe se kjo çështje pas një kohe do të harrohet. Caktimi i modalitetit të

kompenimit, dinamika e kompenimit i futë qytetarët në një labirint burokratik dhe përfitues të vetëm këtu do të jenë, ZRRE, si organizatë e strukturuar kriminale si dhe operatori aktual që pamëshirshëm i plaçkitë konsumatorët përmes rritjes së çmimit të rrymës në kohën kur qytetarët e Kosovës po përballen me probleme të mëdha të natyrës ekzistenciale. Reduktimet e paralajmëruara që po arsyetohen se janë shkak i prishje në fakt është se rryma po iu shitet vendeve të rajonit që po kanë mungesë të energjisë elektrike”, thuhet në reagim. KMDLNj u ka bërë thirrje qytetarëve të Kosovës të kërkojnë kompenzim përmes padive individuale dhe të mos heqin dorë nga realizimi i kësaj të drejte që me vendimin e saj ua ka njohur edhe Gjykata Supreme e Kosovës. “KMDLNj do t'i përkrahë qytetarët e Kosovës që kërkojnë kompenzim sikur që kërkon përgjegjësi ligjore për abuzuesit me të drejtat e njeriut përmes plaçkitjes së buxhetit familjar në dobi të një pale tjetër, qytetarëve të veriut të Kosovës”, thuhet në reagimin e KMDLNj-së.

Hoti përmend katër probleme të pagës minimale

PRISHTINË, 20 KORRIK - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka treguar për katër problemet e Ligjit për Pagën Minimale që u miratua javën e kaluar në Kuvend. Si problem i parë, ai ka thënë se nuk është përfillur procedura ligjore për caktimin e pagës minimale. Ndërkaq problemi i dytë, sipas Hotit, është se nuk është përfillur formula për caktimin e pagës

minimale, e cila bazohet në koston e jetesës. “Katër problemet e pagës minimale, që u miratua javën e kaluar me ligj: 1. Nuk është përfillur procedura ligjore për caktimin e pagës minimale, pasi nuk ka pasur dakordim mes partnerëve socialë (qeverisë, bizneseve dhe sindikatave); 2. Nuk është përfillur formula për caktimin e pagës minimale, e cila formulë bazohet në

koston e jetesës; 3. Janë shkelur dy konventa të Organizatës Botërore të Punës lidhur me hapat që duhet ndjekur për caktimin e pagës minimale; 4. Niveli prej 250 euro i pagës minimale është caktuar vitin e kaluar, para inflacionit që përjetuam, dhe sot nuk vlen ai vlerësim pasi janë rritur dukshëm çmimet e mallrave elementare”, ka shkruar Hoti në “Facebook”.



Vramendje vere për fatin e letërsisë ...

Nga: Josif PAPAGJONI

Para do kohësh po ndiqja një histori njerëzore të "Diela Shqiptare" e TV Klan-it, njohjen e nënës me bijën e humbur, e cila kishte ndërtuar një tjetër jetë, lumturia e takimit etj. Emisione të tilla, ku histori njerëzore prekëse, mbushur me mall, aventura të habitshme e gati të pabesueshme, njerëz të vuajtur a çudanë, me çartje, aventura jete, sflitje, sakrificë, përkushtim, fate të habitshme, dashuri apo urrejtje etj. – televizionet tona tanimë transmetojnë rëndom duke u falur njerëzve emocione të bukura. Por, teksa e ndiqja këtë histori, më kaploi tundimi për të cekur një ide që shpesh hidhet e trajtohet gjerazi në mendimin lidhur me të ardhmen e letërsisë, si mund të jetë ajo dhe a mund të jetë, apo do të shuhet, do të ndryshojë trajtë, do të rimodelohet etj?!

Jo pak arte kanë lulëzuar dikur dhe kanë vdekur më pas. A i kërcënohet letërsisë, të themi, një plakje, shuarje, një largim të vëmendjes dhe zëvendësim me diçka tjetër?

Teoritë estetike, sidomos qasjet eseistike, sjellin pandehma fatale; teknologjia e lartë, që do të sofistikohet më tutje me inteligjencën artificiale, do ta kthejë çdokënd në një shkrimtar ... Sot letërsinë gati e ka përgjybur televizioni, filmi, serialet, imazhi, të cilat sjellin histori tronditëse. Pra, "narrativën", elementin bazik të letërsisë, po ia rrëmbejnë të tjerët. A do të humbasë ajo pak nga pak impaktin me lexuesin e gjerë dhe a do tkurret e zvogëlohet sa një "gogël" përballë një lexuesi të ngeshëm, disi sqimatar, le ta quajmë edhe aristokrat, intelektual, në daçi edhe snob? A do ta përballojë sulmin e tmerrshëm të televizionit dhe imazhit, në përgjithësi, me historitë e gjalla e subjektet tërheqëse plot interes që ato transmetojnë orë e ditë, apo do të katandiset në një bisht, në relikte a fosile?! ... Ose pak më shkurt: letërsia do rrëfjë histori ngjarjesh e njerëzish apo do kridhet në krijimin e një tjetër bote, ku burim do të jetë gjithnjë e më shumë trillimi, sendërgjia, realitetet virtuale, të tejetshme, ku do të luhet fort me përjetimin, shpirtin, ëndrrat, shkrepletet e imagjinatës dhe sajatat e fantazisë? A do ta braktisë letërsia lëndën e jetës së njëmendtë, a do të preferojë akoma të jetë ajo një letërsi realiste, ku shëmbëllimi i kësaj jetë do të mbetet kushti ekzistencial? Dhe, këtu mbërrimë te elementi

parak i letërsisë: rrëfimi, narrativa. Shkurt, të të shkruarit e një historie, shpeshherë e gjitha kjo e njohur apo e quajtur si subjekt. Ani pse letërsia i modernon format dhe mjetet e veta shprehëse, gjithsesi mënyra e të rrëfyerit dhe vetë rrëfimi i një historie, krijimi i një subjekti, ka qenë e mbetet në një shumicë rastesh e veprash të mëdha, çështje e palcës së letërsisë, e faktit përse ajo ekziston dhe funksionon. Kam lexuar qindra e qindra libra, por edhe kur letërsia i largohet jo pak formës klasike të rrëfimit e subjektit, kur i vështirëson enkas ato, unë e dua letërsinë që të jetë aktive në raport me mua si lexues, të jetë e ëmbël dhe e mirëseardhur, ndryshe, sado e lakuar si moderne e postmoderne, kjo letërsi nuk më ngroh. Ajo ma humb kureshtjen, ma fashit ndjesinë e ndjekjes me ankth e tension të historisë deri në faqen e fundit. Madje, edhe shkrimtarë të mëdhenj si Xhoisi dhe Prusti më kanë lodhur me romanet e tyre, paçka se lëvdohen si shpikës të një mënyre të re rrëfimi të ashtuquajtur "përroi i ndërgegjes". Madje, "Ulisi" e Xhoisit e lexova dy herë, herën e dytë si me inat për të vërtetuar se shijet e mia, pas 20 e kusur vjetësh, kur romani u botua së pari në shqip, diçka ishin përpunuar. Por, jo, më lodhi po njësoj ... Jam unë vallë pa shije e formim letrar apo ky lloj i letërsisë moderniste, eksperimentale, ka një tjetër kod komunikimi, ecën në të tjera shina që nuk janë ato të letërsisë, le ta quajmë klasike?! Mirëpo, kjo letërsi edhe sot, paçka se kanë kaluar dekada, mund të shijohet nga fare pak njerëz, ndërsa të tjerët janë jashtë banketit të tyre?

Çfarë dua të them te kjo ese?

Letërsia e nesërme a mund të bëjë pa rrëfimin, pa tregimin e një historie interesante, befasuese, origjinale, të mëvetëshme? Apo, ajo do të pëlqejë udhë të tjera, përtej narratives, duke i mëshuar krijimit të situatave emocionale nën trysni, ose anktheve, zhbirilimeve, traumave ku qenia ndodhet si në një bosh, mugëtirë, medium të parrokshëm, ashtu as kështu, duke sjellë "apokalipsin" e një vetëdijeje të çoroditur, gati ne trans?! A është i tejkualuar "rrëfimi" si element substancial i letërsisë (romani) apo kjo priret te të tjera modelime, me përdorime simbolikash e qasjesh metaforike që mbërrijnë në krijime realitetesh tërësisht virtuale, po njësoj edhe me sendërgjime e krijime marrëdhëniesh njerëzore që merren thjesht si pretekste, për të ofruar më pas situata alogjizmi, apo ato të absurdit, të kotësisë, të



sajimeve mitologjike, të realiteteve paradoksale, të kllapive, situata psikotike sipas pirjes a injektimit të drogave etj?! Unë them se një letërsi e tillë nuk do të jetë asnjëherë zotëruese, asnjëherë e pëlqyer nga një lexues masiv dhe "normal", që nuk ka për mision ta lodh kokën me gjësende që e vështirësojnë kuptimin dhe perceptimin, por që kërkon të kënaqet estetikisht. Nëse letërsisë i dobësohen dy ashtet e saj, rrëfimi dhe joshja (kënaqësia), ajo i ikën funksionit të vet zgjedhor dhe e tradhton specifikën estetike. Lexuesi kërkon të identifikohet me personazhet dhe peripecitë e tregimit, romanit. Po ia dobësove a ia hoqe këtë lidhje, letërsia e humbet fuqinë empatike të saj, nuk bëhet dot një dytës dhe bashkëshoqërues i yti si lexues i saj. Magjia humbet. Por, nga ana tjetër, këto të dyja, sidomos e para, pra sjellja e historive njerëzore interesante, prekëse, të veçanta, atakohet dhe konkurrohet jo pak aktualisht nga televizionet dhe historitë tejet interesante që ato i japin publikut masiv shqiptar si një "gjellë" kazani, pra njerëzve të thjeshtë, "ushtrisë", pa shumë pretendime dhe sofistikime ndaj artit. Duhet thënë se jo pak histori njerëzore në televizione, janë tejet të pëlqyeshme, ndikuese dhe me impakt të fortë në popull. Letërsia përpara tyre shqyen sytë! Pandehma të frikshme thonë se letërsia dhe artet, në kushtet e teknologjive të larta të komunikimit, imazhit, përpunimit figural etj., do të konkurrohen aq fort prej këtyre sa ose do të vdesin (të cilën s'e besoj), ose do të ndryshojnë me themel formën dhe thelbin e tyre zgjedhor estetik. Dhe, këtu edhe unë besoj se letërsia që po vjen do të modifikojë në mënyrë të ndjeshme formën e shprehjes artistike për të rekrutuar lexuesit e saj, gamën e mjeteve se si ta bëjë sa me shumë tërheqëse vetveten për lexuesin e gjerë, duke u dhënë atyre njëherazi


ndjeshmëri, mistike, përsiatje, kënaqësi dhe dëshirë për çaste filozofimi, arrati nga jeta e rëndomtë, meditim. Një grimë herë dua të kujtoj eposin homerik, "Iliadën" dhe "Odiseun". Vallë i lexon kush ato sot? Shumë, shumë pak njerëz, ndofta ca studentë, pedagogë dhe njohës të letërsisë i lexojnë. Më bukur ato i sheh në filma. Po "Luftën dhe Paqen" të Tolstoit, e lexon kush vallë nga të rinjtë e sotëm? Druaj, se jo! Poezia epike pati kohën e vet, iku, u shua. Edhe romanet shumëvëllimëshe, si epose popujsh e ngjarjesh të mëdha historike, nuk pëlqehen më. Njerëzit s'kanë më durim. Shpejtojnë. Ritmi është tejet i lartë. S'ka më nge. Vendin e këtyre eposeve me mijëra faqe e zunë të tjera forma, që edhe pse janë epike, janë shumë dinamike. A lexohet valle "Lahuta e Malcis" e Fishtës sot, dikur tejet e pëlqyer, e mbajtur përmendësh dhe e recituar gjithkund? Ku është teatri antik grek? Mënyra si bëhej teatri asaj kohe, sidomos kërkesa dhe impakti psikosocial me publikun qenë tejet aktive, përfshirë edhe religjionin me ndjeshmëritë e thukëta ku shfaqja shndërrohej në akt civil, politik dhe fetar. Ajo lloj formë e teatrit vdiq. Po kështu Comedia dell' Arte etj. Po. Arti në vetvete nuk vdesë, njeriu do të ketë nevojë për krijimin. Mirëpo, format e tij ndryshojnë, paçka se teori të ndryshme futuriste vërtetojnë se ai, arti, do të "vdesë" dhe do të zëvendësohet me forma të tjera kënaqësie dhe komunikimi. Që mos të përhumbem në hamendjesime, po zbres në tokë me pyetjet: A rrezikohet, p.sh., poezia, sidomos ajo epike? Po romani i stërgjatë ku të duhet të gëlltitësh tonelata me "ujë", përshkrime imtësish jo fuçia atje, jo jaka e palosur këtu, jo fijet e flokut ashtu etj. Kam një ndjenjë frike dhe stepjeje për letërsinë shqipe sot, për shkrimtarët e panumërt që botojnë gjithkund e gjithherë, dhe të gjithë fitojnë çmime

ndërkombëtare nga qytezat dhe fshatrat e shumtë. A lexohen vallë? A janë interesante romanet e tyre? Deri ku dhe deri sa lexuesi priret drejt kësaj letërsie të pashoshur, drejt këtij apo atij shkrimtari. Sa është tirazhi i një romani? A ia vlen të botosh 30 a 50 kopje me paret e tua dhe t'ua japësh ca miqve e bibliotekave falas, pa para? A janë vallë më interesante këto histori njerëzore, që vijnë nga ekranet televizive, sesa historitë e përpunuara artistike të romaneve të sotme? A i njeh kush këto romane? Pse s'lexohet sot? Vallë fajin e ka vetë letërsia me mediokritetin e saj dhe lumnajen e shkrimtarëve dhe librave të tyre pa sens, pa vlerë e pa kriter, apo e ka fajin mungesa e lexuesit, thënë më qartë niveli i ulët i këtij lexuesi, mungesa e dëshirës së të lexuarit duke e ngopur veten me lexime në celular, kafe, birra, kotësi, gromësima. Pra, vetë shoqëria me ca mjete e mënyra të tjera se si po e ofron leximin, vetë letërsinë. Mos ndofta shoqëria vetë, edhe ajo shqiptare, po e zëvendëson pak nga pak letërsinë me forma të tjera rrëfyese, pamore, edhe më aktive se germa, edhe më të thjeshta dhe pa e lodhur syrin, mendjen? Do të jetë nesër letërsia pjesë e vllgut, e një konsumi masiv për të mbushur stomakët e kënaqësive të thjeshta në ditë plazhesh apo do vetëmbyllet te një pakicë lexuesish të ngeshëm, me shije?

Besoj jemi të një mendjeje se sot lexohet shumë pak letërsi. Njerëzit nuk kanë qejf të lodhen me gravitetin e ideve, mendimeve, figurave dhe gjithë atyre finiturave e sofistikimeve që ajo, letërsia si art, i ka dhe i përdor me qejf?! Kam frikë se edhe letërsia do të marrë plagë të rënda nga topuzët e kohës së re. Janë topuzët të një perandorie skllëverish të rinj, që përtojnë të lexojnë, gërryer nga ankthet, ritmi i lartë, pamundësitë. Dhe, të kthyer në shtëpitë e veta, sflitur nga puna dhe stresi, vetëmjaftohen me fuqinë e formave moderne te komunikimit dhe perceptimit nëpër ekrane celulari dhe Ipad-esh, teksa subjektet interesante i vijnë si salcra të gatshme nga ekranet televizive. E ç'i duhet më shumë!

A do të vdesë, pra, letërsia apo do të mbijetojë?! A do ta gëlltisin atë format e reja, teknologjitë e larta të imazhit dhe të zërit, llojet e reja të perceptimit artistik, ato vizive dhe ato auditive? Kush të rrojë, ka kohë. Me një kafe a birrë para, këtu në Sarandë bri plazhit ku unë kaloj paraditen, ju ftoj dhe ju njerëz të letrave të meditoni cazë, për qejfin tuaj ...

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Kosova bie për një pozitë, Shqipëria nuk ndryshon në renditjen e FIFA-s

PRISHTINË, 20 KORRIK - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka rënë për një pozitë në renditjen e FIFA-s për muajin korrik. Tash "dardanët" janë në pozitën e

109, duke u renditur pas Madagaskarit dhe përpara Taxhikistanit. Ndërkaq, Kombëtarja e Shqipërisë nuk lëviz vendi, duke mbetur në pozitën e 65-të me 1 357 pikë.

Kuqezinjtë, të cilët me trajnerin Sylvinho e nisën mjaft mirë kampanjën kualifikuese për "Euro 2024", gjenden përpara Kepit të Gjellbër dhe prapa Afrikës së

Jugut. Në renditjen e përgjithshme vazhdon të prijë kampionia e botës, Argentina. E dyta është Franca, kurse podiumin e mbyll Brazili.



Kosova synon kualifikimin në Evropianin U22 në volejboll

PRISHTINË, 20 KORRIK - Pas suksesit të jashtëzakonshëm në Kampionatin Ballkanit të Baech Volley, ku Kosova u shpall kampione në konkurrencën e femrave si dhe nënkampione në atë të meshkujve, Federata e Volejbollit po kërkon një tjetër sukses në garat evropiane, kësaj radhe në Kampionatin Evropian të Volejbollit për grupmoshat U22 në konkurrencën e femrave. Ky Evropian do të zhvillohet në Republikën e Çekisë dhe do të nisë më 22 korrik. Sekretari i kësaj federate, Valon Nikqi, ka thënë për "KosovaPress" se vajzat kanë bërë përgatitjet e duhura dhe janë në formë shumë të mirë para këtij kampionati. "I kemi filluar përgatitjet për ditë me radhë. Përgatitje janë duke shkuar mjaft mirë. Kampi i kombëtares U22 në konkurrencën e femrave është duke i bërë përgatitjet në qytetin e Skenderajt dhe është duke

kaluar mjaft mirë. Për shkak të aktiviteteve të tjera që janë gërshtuar, disa lojtare kanë qenë edhe pjesë e kombëtares U19, mirëpo edhe disa aktivitete të 'beach volley', ka pasur herë pas here mungesa, mirëpo ne dje e kemi vizituar kampin së bashku edhe me kryetarin dhe përgatitjet janë duke shkuar mjaft mirë", ka thënë Nikqi.

Në grup me Kosovën janë kombëtare të forta si Turqia, Austria dhe Çekia por, përkundër kësaj, Nikqi është i bindur se Kosova do të ketë rezultate të mira në këtë kampionat. "Sa i përket grupit, grupi është mjaft i fortë, kemi të bëjmë me kombëtare mjaft të forta siç është kombëtarja e Turqisë, kombëtarja e Çekisë e cila është edhe nikoqire e turneut, gjithashtu edhe Austria është një kombëtare në rritje, kështu që nuk do të jetë aspak e lehtë, mirëpo me siguri që kombëtarja



jonë do të udhëtojë atje dhe do të synojë rezultate sa më pozitive edhe pse përballë do të kemi kombëtare mjaft të forta", ka

deklaruar Nikqi, i cili ka shtuar se gjatë këtij viti Kosova do të marrë pjesë edhe në shumë gara ndërkombëtare me grupmosha të

ndryshme dhe se qëllimi i të gjitha këtyre aktiviteteve është që Kosova të përfaqësohet denjësisht edhe në sportin e volejbollit.

Berisha: Fitore e madhe ndaj Zvicrës, nuk ndryshojmë edhe ndaj Danimarkës



PRIZREN, 20 KORRIK - Përfaqësuesja e basketbollit të Kosovës e ka demolu Zvicrën duke e mposhtur me rezultat bindës 76-49. Kapiteni i "dardanëve", Dardan Berisha, është shprehur shumë i kënaqur me paraqitjen e bashkëlojtarëve dhe suksesin e arritur të mërkurën në mbrëmje ndaj zvicranëve. "Jemi shumë të lumtur. Kemi ushtruar gjatë për këtë ndeshje. Kemi dëshmuar se

jemi përgatitur shumë mirë, ndonëse disa kanë dyshuar. Shpresojmë që edhe në ndeshjet e tjera do ta kemi këtë energji. Loja jonë ishte shumë e mirë. I përgëzoj të gjithë lojtarët, trajnerët, për atë që kemi bërë deri më tani. Shpresojmë të kemi sukses edhe në ndeshjet e tjera", ka thënë Berisha, i cili ka paralajmëruar se Kosova ka synime të mëdha edhe në ndeshjen e radhës ndaj

Danimarkës. "Do të vazhdojmë me këtë sistem. Shkojmë në Danimarkë për ta dhënë maksimumin. Do të jetë më vështirë, por do të shkojmë për të fituar. Do të shkojmë hap pas hapi. Po shpresoj që do të kemi rezultat të mirë. Duhet të qëndrojmë me këmbë në tokë. Nuk është bërë asgjë me këtë fitore. Na presin edhe tri ndeshje", ka deklaruar Berisha.

Shqipëria më 17 tetor zhvillon miqësore me Bullgarinë

Tiranë, 20 korrik - Kombëtarja shqiptare do të luajë një miqësore me Bullgarinë. Federata Shqiptare e Futbollit ka arritur pajtim me Federatën Bullgare që kjo ndeshje të luhet më 17 tetor 2023 në stadiumin "Air Albania" të Tiranës, ndërsa orari mbetet për t'u përcaktuar. FIFA ka lënë data të lira për të gjitha kombëtares që janë në

grupe me nga 5 ekipe. Më 12 tetor kuqezinjtë e drejtuar nga trajneri Silvinjo do të luajnë ndaj çekëve në stadiumin 'Air Albania', një sfidë e vlefshme për kualifikueset e Kampionatit Evropian "Gjermani 2024", e tri ditë më vonë ndaj Polonisë. Sa i përket miqësore me Bullgarinë, kjo do të jetë hera e 11-të që dy

përfaqësueset ballkanase do të përballen në një ndeshje futbollit. Në të kaluarën Shqipëria dhe Bullgaria janë përballur jo vetëm 'miqësisht', por edhe në ndeshje të vlefshme për kualifikueset të Kampionatit Evropian, eliminatorë të Kampionatit Botëror, por edhe për Kupën Ballkanike.



Muriqi: Nuk dua të largohem dhe nuk dua të më shesin

Mallorca, 20 korrik - Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës, Vedat Muriqi, ka konfirmuar edhe një herë vendimin e tij për të qëndruar te Mallorca. Ylli "dardan" kishte nënshkruar kontratë afatgjatë vitin e kaluar dhe krejt fokusin e ka

te klubi ishullor spanjoll. "Unë nuk dua të largohem dhe nuk dua që Mallorca të më shesë", ka deklaruar Muriqi për "Diario de Mallorca". Madje ai ka aspirata të mëdha me ekipin e La Ligas. "Shpresoj ta kemi një vit edhe më të mirë. Do të

ishte një ëndërr ta fitojmë Copa del Rey dhe të luajmë në Evropë", ka shtuar Muriqi, i cili ka realizuar 15 gola në sezonin e kaluar në kampionatin spanjoll dhe pesë të tjera paraprakisht në gjysmë edicioni sa ishte i huazuar nga Lazio. "Unë nuk

ndihem yll i ekipit. Nuk kam bërë ende asgjë", ka përfunduar Muriqi. Për ish-futbollistin e Fenerbahçes dhe të Lazios thuhet se interesim kanë shfaqur klubet e La Ligës, të Premierligës, të Serisë A dhe të Superligës turke.



Eto'o i përfshirë në një skandal të madh të kurdisjeve

YAOUNDE, 20 KORRIK - Zbulime shqetësuese kanë dalë në lidhje me përfshirjen e supozuar të presidentit të Federatës së Futbollit të Kamerunit, Samuel Eto'o, në kurdisje ndeshjesh, pasi ai premtoi të ngrinte një klub nga Liga e Dytë në ligën më të lartë. Samuel Eto'o është në trazira. Një episod i ri i është shtuar serisë së polemikave rreth presidentit të Fecafoot kohët e fundit. Vetëm pak ditë pasi ish-zëvendësi i tij, Njalla Quan, bëri deklaratë gjithëpërfshirëse duke e akuzuar se e kishte larguar Andre Onanën nga kombëtarja, "bosi" i futbollit të Kamerunit është sërish në qendër të vëmendjes. Këtë herë Eto'o dyshohet për përfshirje në kurdisje ndeshjesh dhe kjo thuhet se është e paprecedentë në historinë e futbollit kamerunas. Një regjistrim audio, i shpërndarë gjerësisht në rrjetet sociale që nga e marta më 18 korrik 2023, paraqet Eto'on në një bisedë telefonike me presidentin e klubit lokal të divizionit të dytë Opopo, i njohur më mirë si Victoria United. Në këtë bisedë, e cila daton nga



janari 2023, Eto'o dëgjohej duke u zotuar se do ta çojë klubin në divizionin më të lartë. "Opopo duhet të ngjitet në divizionin e parë. Ky është qëllimi ynë. Është Federata jonë. Janë katër prej nesh, të cilët kemi qenë disa muaj, ju dhe dy të tjerë. Victoria duhet të ngjitet lart", dëgjohej Eto'o duke thënë. Disa muaj më vonë, Victoria, e cila ishte në mesin e tabelës, u promovua në ligën e parë si kampione pasi përfundoi në vendin e dytë, ndërsa vendi i

parë Stade de Bertoua shpalli tërheqjen nga liga nga Fecafoot. Përveç kësaj, disa gjyqtarë u pezulluan nga organi me bazë në Yaounde. Gjatë sezonit shumë protesta të gjyqtarëve u ngritën kundër Opopo. Këto zbulime ngrënë pikëpyetje rreth ndikimit të mundshëm të Eto'os në vendosjen e rezultateve të ndeshjeve, duke devijuar kështu rezultatin e ndeshjeve nga rezultati i tyre real në fushë, për t'u vendosur në zyrat e Fecafoot.

Alcaraz, milioner që në moshën 20-vjeçare

MADRID, 20 KORRIK - Grand Slam i Wimbledonit është turneu më i rëndësishëm i tenisit, ndër më të vjetrit në botë, i famshëm edhe për faktin se premio që jepet për sportistët është i madh. Këtë sezon premio i dhënë për fituesin ishte më i larti në histori: 3.2 milionë euro. Një shumë që u arkëtua nga tenisti spanjoll Carlos Alcaraz, fitues i këtij turneu, pas fitores 3-2 në finale ndaj Novak Djokoviqit. Shifër marramendëse për një tenist që është vetëm 20 vjeç dhe në fillimet e karrierës. Ky ishte grand slami i dytë i fituar nga Alcarazin në karrierë, që ka fituar edhe mjaft turne të tjerë Masters apo më të vegjël. Sipas medieve, deri më tani Alcaraz ka fituar 20 milionë euro nga premiot e ndryshme, duke shkëlqyer me



lojën e tij. Alcaraz është numri 1 në botë dhe po dominon, duke qenë pasardhës i këtij sporti. Paraqitjet e tij kanë sjellë edhe

mjaft sponsorë, si Rolex, orën të cilën spanjollit e mbante në dorë gjatë ceremonisë (vlerë 120 mijë dollarë).

SHKURT

Tuchel: Kimmichi është i paprekshëm

Mediet gjermane të mërkurën raportuan se Bayern Muncheni është i gatshëm ta shesë edhe yllin e skuadrës Joshua Kimmich. Mirëpo një lajm të tillë e ka mohuar trajneri Thomas Tuchel. "Frazat se gjithçka mund të ndodhë në merkato nuk nënkuptojnë medoemos se të gjithë lojtarët janë në shitje. Joshua e ka treguar se sa i rëndësishëm dhe jetik është për ekipin dhe kjo gjë do të vazhdojë të jetë e njëjtë edhe në sezonin e ri, kështu që të fokusohemi në detajet e tjera", ka thënë Tuchel. Kimmichit i skadon kontrata me "bavarezët" në verën e vitit 2025.

Presidenti i Lazios: Immobile nuk është në shitje

Presidenti i Lazios, Claudio Lotito, këmbëngul se Lazio nuk ka marrë asnjë ofertë për Ciro Immobile duke thënë se ai nuk është në shitje. "Sportitalia" raportoi se Lazio kishte marrë një ofertë prej 30 milionë eurosh nga një klub saudit për italianin, ndërsa oferta për Immobile ishte 18 milionë euro në sezon. "Immobile nuk është në treg dhe ne nuk kemi marrë asnjë ofertë", ka thënë Lotito. Në një intervistë të mëparshme, Lotito kishte pohuar se çmimi minimal i kërkuar për Immobile ishte 50 milionë euro. "Bianconcelestët" kanë shitur tashmë mesfushorin Sergej Milinkovic-Saviq në Al-Hilal për 40 milionë euro këtë verë.

Mahrezi kalon tek Al Ahli

Riayd Mahrez ka arritur marrëveshje personale me Al Ahlin, ndërkohë që edhe vetë klubi saudit ka arritur ta bindë Manchester Cityn që për 35 milionë euro ta lë lojtarin të lirë. Dokumentet janë duke u shkëmbyer mes dy palëve dhe deri në fund të javës pritet të vijë edhe firma e lojtarit me klubin e tij të ri. Mahrezi do të firmosë një kontratë deri në qershor të vitit 2027.

Cuadrado: Nder për mua të jem në një nga ekipet më të mëdha në Evropë

Juan Cuadrado u zyrtarizua ditën e djeshme si lojtari më i ri i Interit. Kolumbiani u telefonua nga Marotta dhe nuk ngurroi ta pranonte ofertën zikaltër, duke u transferuar kështu te rivalët e ish-klubit të tij, Juventusit. "Kam pasur shumë oferta, por Italia është një shtëpi e dytë për mua. Familja ime është shumë e lidhur me këtë vend. Ekzistonte mundësia për të qëndruar këtu me një ekip të madh. Zgjedhja Interin sepse të gjithë e dimë historinë e këtij klubi dhe se çfarë përfaqëson në botë. E rëndësishme është se unë dhe familja ime jemi mirë, patëm mundësinë të qëndrojmë në atë që është shtëpia për ne dhe sigurisht ishte zgjidhja më e mirë. Jam shumë i lumtur. Falënderoj Zotin për këtë mundësi! Është një nder për mua që jam këtu në një nga ekipet më të mëdha në Evropë", është shprehur Cuadrado.

Neymari: Me ose pa dashuri, unë do të jem aty

Sulmuesi brazilian Neymar Junior ka konfirmuar qëndrimin e tij te Paris Saint-Germain së paku edhe për sezonin e ardhshëm 2023/24. PSG-ja ka bërë

shumë ndryshime në këtë verë, me afrimin e trajnerit Luis Enrique dhe transferime të mëdha si Milan Skriniar, Marco Asensio dhe Lucas

Hernandez. Megjithatë, nga klubi është larguar Lionel Messi pas skadimit të kontratës dhe për një largim janë përfolur edhe dy yjet e tjerë si Neymar Jr dhe Kylian

Mbappe. "Shpresoj të jem në PSG sezonin e ardhshëm. Unë kam kontratë. Askush nuk më ka njoftuar për asgjë deri tani. Jam i qetë", ka thënë fillimisht Neymar për

"Caze TV". "Edhe pse nuk ka shumë dashuri mes tifozëve dhe lojtarëve, do të jem atje. Me dashuri ose pa dashuri, por me Neymarin", ka shtuar Neymari.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: Furnizim Shërbime Punë

Nr. i Prokurimit 07-23

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbrojnë veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën **Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin:**

Dosja për: Kontratë për përkthim dhe lekturim të dokumenteve të OMK-së

Në pajtim me Nenin 9, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).


Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **02.08.2023 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **04.08.2023 ora 12:00.**

Hapja e ofertave bëhet me datën: **04.08.2023 ora 14:00.**



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ilirjane Ferizi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

